

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Asgjësimi / *el-Fanaa* / الْفَنَاءُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ وَيَبْقَىٰ وَجْهَ رَبِّكَ"

“Çdokush mbi të (tokë) do të asgjësohet dhe do të mbetet Fytyra e Zotit tënd.”  
(er-Rahmaan, 26-27)

Asgjësimi<sup>1</sup> në këtë kontekst i referohet zbehjes së asaj që është tjetër gjë veç të Vërtetit për sa i përket dijes, pastaj mohimit, pastaj realizimit<sup>2</sup>. Kjo ka tri nivele.

---

<sup>1</sup> *Fanaa* që shpesh përmendet në diskursin sufut, mund të nënkuptojë një nga tri gjërat. E para është esenca e adhurimit. E dyta ka disa anë fisnike, të domosdoshme për devocionin personal, dhe të tjera anë që në vetvete nuk kanë vlerë dhe mund të jenë problematike. E treta është krejtësisht blasfemi.

E para është asgjësimi i vullnetit personal dhe shpërbërja e tij e plotë në vullnetin e Allahut. Kjo ende s'është një bashkim ontologjik (qenësor) ose një bashkim vullnetesh, sepse vullneti është një tipar karakteristik i çdo qenieje, dhe një bashkim i plotë vullnetesh do të nënkuptonte një bashkim të plotë qeniesh. Mirëpo, ky asgjësim vullnetesh (*fanaa el-iraadaat*) ka të bëjë me nënshtrimin e plotë të vullnetit tonë ndaj atij të Allahut. I Dërguari i Allahut ﷺ tha: "Asnjë prej jush nuk do të besojë njëmend, derisa t'i ketë dëshirat të nënshtruara ndaj asaj çfarë solla" (et-Taberani). Kjo është pika ku "zemra nuk dëshiron gjë tjetër veç Zotit duke u mbështetur tek Ai e duke adhuruar Atë, dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me këtë. Kjo është e vërtetë dhe e saktë, dhe është esenca e teuhidit dhe e devocionit." (Ibn Tejmije, *Mexhmu el-Fetaawa* 10:337) Ky lloj i shpërbërjes (*fanaa-s*) është shpërbërje në adhurimin e Zotit (*uluhije*) dhe nuk bie ndesh në asnjë mënyrë me *bekaa*, që është qëndrim nëpërmjet Allahut, me Allahun, për Allahun.

E dyta është asgjësimi (*fanaa*) perceptues. Një pjesë e kësaj shpërbërjeje është me vlerë dhe më superiore. Kjo është pika ku personi arrin të kuptojë ekzistencën e krijesave, por ato asnjëherë nuk e pengojnë të shohë hyjnoren, të Vërtetin, filluesin e të gjitha gjërave dhe kontrolluesin përfundimtar. Kjo është shpërbërja në zotësinë e Zotit (*rububije*), kur ti sheh krijesat, duke njohur varësinë e tyre, karakterin kalimtar të tyre, dhe parëndësinë e tyre; ato do të jenë si një pllakë qelqi që asnjëherë nuk të pengon të shohësh përtej tyre. Kur ato të dëmtojnë ose të bëjnë mirë, në veprat e tyre ti sheh caktimet dhe punën e Tij. Përgjigjja jote në këtë do të jetë vetëdija jote për Të, jo për ato (krijesat). Ky është thelbi i shkallës së *ihسانit*, ku ti adhuron Allahun sikur ta shihje. A mund të imagjinosh të të shpërqendrojë ndonjë gjë tjetër (*siwa*), sikur ta shihje Atë?

Ka dhe një formë tjetër të këtij asgjësimi perceptues, që është shpërbërja e vetvetes në fokusin e vëmendjes së asgjësimit, ku objekti i vëmendjes së përthithur fiton një intimitet që i përket vetës, çka më tej rezulton në një gjendje të vetëdijes së ndryshuar, që i bënë disa njerëz të ndiejnë praninë e Zotit deri në masën ku edhe mund të shprehin fjalë herezie, të cilat quhen *shatahaat*. Ndërsa shprehjet e këtilla nuk janë të admirueshme dhe mund të konsiderohen edhe akte mohimi (mosbesim / kufër), po të thuheshin jashtë këtyre gjendjeve, shumë dijetarë, përfshirë dhe Imam Ibn Tejmije, mbanin qëndrimin se, ata që shprehin këso fjalë, do të falen për shkak të kësaj dehjeje shpirtërore (*Mexhmu el-Fetaawa* 10:340). Si shembull të këtyre *shatahaat* ai përmendi shprehjen e Ebu Jezid el-Bistami "Lavdia qoftë për mua (*subhani*)!" Që këto shprehje të falen, duhet përmbushur kushte të caktuara. Gjendja e transit duhet të jetë e vërtetë, jo një shtirje, dhe duhet të arrihet në mënyra hallall. Shprehjet duhet të jenë të shkurtra, me vetëm pak fjalë. Personi që shpreh ato, me të dalë nga ai trans, ndien keqardhje që i ka thënë dhe, madje, i mohon, siç bënte edhe Ebu Jezid. Personi po ashtu duhet të jetë praktikues i Sunetit dhe zbatimin fetar ta ketë në përputhje me Sheriatin. Në fund, siç sqaron Imam Ibn Tejmije, shprehjet e këtilla nuk qenë përcjellë nga krijesat më të mira – pejgamberët dhe sahabët. Kjo për

Niveli i parë është shpërbërja e njohjes në Atë i cili njihet, dhe kjo është *fanaa* e dijes<sup>3</sup>; shpërbërja e të parit në të parët, që është *fanaa* e mohimit<sup>4</sup>; dhe shpërbërja e kërkimit në realitetin, që është *fanaa* e realizimit<sup>5</sup>.

---

shkak të fuqisë së njohjes dhe mendjes së tyre si edhe aftësisë së tyre për të parë shumësinë e dukurive dhe të krijesave ndërsa ishin plotësisht të vetëdijshëm për njësinë e Krijuesit, të Përjetshmit, të Vërtetit. Një njohje e plotë e këtillë i mbron ata që të mos kaploheshin nga ndonjë dehje shpirtërore. *Bekaa* (qëndrimi) nëpërmjet Allahut, me Allahun, për Allahun, është më e lartë sesa *fanaa* (vetasgjësimi). Ky është thelbi i thënies së Allahut: "... derisa Unë ta dua aq sa bëhem dëgjimi i tij me të cilin ai dëgjon dhe të parët e tij me të cilin ai sheh." Nëse personi sheh nëpërmjet Allahut dhe dëgjon nëpërmjet Allahut, do të shohë realitetet ashtu siç janë në të vërtetë. Ai asnjëherë s'do të ngatërrohet e as nuk do të ketë ndonjë iluzion (*wemh*).

E treta është lloji heretik i *fanaa*-s, që është asgjësimi qenësor (*fanaa el-wuxhuud*) ose asgjësimi i tërë ekzistencës veç asaj hyjnore, ku pohohet të mos ekzistojë ndonjë gjë tjetër veç Zotit, gjë që pashmangshëm çon në panteizëm / monizëm. Kjo qartazi është e pamundshme, por fatkeqësisht është pranuar nga disa. Kushdo që pohon kësi lloji të vetasgjësimit, nuk duhet as të hajë, as të pijë, as të marrë frymë, nëse shpërbërja e tyre në hyjnoren do të ishte ashtu siç thonë. Kjo do të nënkuptonte që adhuruesi është i adhuruari dhe robi është Zoti. Këso pikëpamjesh heretike mund të vishen me argumente tërheqëse filozofike e retorike për t'i mashtruar masat. Mirëpo, ato janë diametralisht të kundërta me Shpalljen dhe, në fakt, e bëjnë të parëndësishme Shpalljen. Tek e fundit, kjo s'do të kishte dallim mes adhurimit të idhujve dhe adhurimit të Zotit, meqë idhujt, sipas këtyre pikëpamjeve, nuk janë gjë tjetër veçse Zoti. Imam Ibn Haxher tha: "Për sa i përket Ehlu-Sunetit, ata e shpjegojnë teuhidin të jetë një refuzim i asimilimit dhe i mohimit (ngjasim të Zotit me krijesat dhe mohim të attributeve të Tij), dhe kjo është arsyeja mes të Përjetshmes dhe të krijuarës" (*Fet'h el-Baari* 13/344).

<sup>2</sup> Njohuria e personit për Allahun si krijues dhe për nevojën që krijesat kanë për Të thjesht vetëm për të ekzistuar i bën atë të vetëdijshëm se nuk është meritë për ndonjë gjë, çka dhe ishte (asgjë) para se Ai ta nxirrte në ekzistencë. Pas kësaj, personi do të jetë në një gjendje ku do të humbë perceptimin e çdo gjëje tjetër (*siwa*) dhe do të mohojë ato. Pas kësaj, dëshmuesi i këtyre fakteve dhe gjendjeve do të humbë vetveten ashtu që vetasgjësimi i tij të realizohet plotësisht.

<sup>3</sup> Shpërbërja e tyre në *ma'ruf* (të Njohurin) e bën atë të humbë ndjenjat për dijen dhe për njohurit e veta.

<sup>4</sup> Ai mohon çdo gjë tjetër (*siwa*), përfshirë dhe të parit e tij të Zotit.

<sup>5</sup> Pa dyshim, shejhu (el-Harawi) nuk mendoi se kërkimi i Zotit nga personi pushon pasi ai ta gjejë Atë në realitet. Në fakt, sa më shumë që personi i afrohet Atij, aq më i zjarrtë bëhet kërkimi i tij për Të dhe për kënaqësinë e Tij. Shejhu mendoi të thoshte se personi nuk do të ndiejë ndjekjen që bën, sepse ajo ndjenjë do të shpërbëhet në ndjenjën e të qenit të tij me Allahun. Nga fjalët që përmbledhin më së miri shkallën e *fanaa*-s dhe të *bekaa*-s, së bashku me intensitetin e kërkimit të Allahut, është kjo thënie e bukur e el-Xhunejd lidhur me dashjen e Allahut: "Një rob i ndarë nga vetvetja (egoja), i ngjitur për Zotin e Tij nëpërmjet kujtimit që i bën Atij, duke përmbushur vazhdimisht të drejtat e Tij, duke parë Atë me zemrën e tij. Dritat e madhësisë së

Niveli i dytë është asgjësimi i të parit të kërkimit për ta eliminuar kërkimin, asgjësimi i të parit të njohjes për të eliminuar njohjen, dhe asgjësimi i të parit të të parit për të eliminuar të parët<sup>6</sup>.

Niveli i tretë është asgjësimi i të parit të *fanaa*-s. Kjo është *fanaa* e njëmendtë, ku personi sheh pjesërisht shkretimën e realitetit, lundron nëpër oqeanin e bashkimit, dhe ndjek shtegun e qëndrimit<sup>7</sup>.

---

Tij djegin zemrën e Tij dhe ai mbahet gjallë vetëm me nektarin e mëshirës së pakufishme të Tij. I papërmbajtshmi i është shfaqur Atij (zembrës së tij) nëpërmjet perdeve të së padukshmes. Kështu, kur ai flet, e bën këtë nëpërmjet Allahut. Çfarëdo që shpreh, është prej Allahut dhe për Të. Kur ai lëviz, e bën këtë me urdhrin e Allahut. Kur ai qëndron në vend, është me Allahun. Pra, ai është nëpërmjet Allahut, për Allahun, dhe me Allahun.

<sup>6</sup> Këtu personi mundohet të humbë të parit e dijës së vet, dëshmimin (*shuhuud*), dhe kërkimin (e Zotit).

<sup>7</sup> Këtu personi mundohet të humbë të parët e vet të *fanaa*-s, meqë ekziston vetëm i Vërteti. Me këtë, ai mendon në realitetin mendor, jo në atë ontologjik (qenësor). Pas kësaj, personi do të kualifikohet për të qëndruar nëpërmjet Allahut, me Allahun, për Allahun.